



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve
Godina “Liria”
Qyteti Studenti

Tiranë, më 24.07.2020

UDHËZIM për Votuesit (student dhe personel akademik)
“Zgjedhjet për autoritete drejtuese dhe Senatin Akademik të UT-ës”

DATË 30.07.2020

- Votuesit pjesmarrës (student apo personel akademik) në procesin e votimit në datë 30.07.2020 janë të detyruar të respektojnë Aktin Normativ Nr. 29, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave të RSH ku normohet që në ambiente të mbyllura publike duhet të përdoret barriera mbrojtëse(maskë); protokollin e sjelljes Anticovid19 në UT nga administrimi i UT-ës për njësitë kryesore të tij si edhe masat e këtij Udhëzuesi.
- Në mjediset përreth Qendrave të Votimit është e ndaluar rreptësisht prezenca e materialeve të fushatës zgjedhore nga secili kandidat garues. Administratori i Njësisë Kryesore dhe KZF janë përgjegjës për këtë standard zgjedhor.
- Në mjediset e njërive kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve është e ndaluar kategorikisht fushata në mbështetje të kandidatëve garues. Personeli i administrimit në njësitë kryesore të UT merr masat e tij në komunikim me KZF e njësisë ku po zhvillohet procesi i votimit.

Në zbatim të nenit 6, pika 2, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet Drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendim Nr. 5, datë 10.02.2020 nga Senati Akademik i UT-ës,

KIZ udhëzon sa më poshtë:

1. Qendra e votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në 16.00, përfshirë këtu dhe kohën për votim edhe për votuesit që gjenden në rradhë në 16.00.
2. Votuesit duhet të respektojnë gjithë rregullat e protokollit Anticovid të institucionit qysh në hyrje të tij për matjen e temperaturës edhe të jenë të pajisur me maska sipas Aktit Normativ, referuar më sipër, mbi maskat e detyrueshme.



3. Votuesit ndjekin sinjalistikën për t'u drejtuar në qendrën e tyre të votimit, respektojnë radhën jashtë qendrës së votimit, **duke respektuar distancimin social sipas sinjalistikës së vendosur** në mjediset universitare sikurse dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen nga një anëtar i komisionit të QV.
4. Në Qendrën e Votimit është i ndaluar kategorikisht përdorimi i celularit si nga votuesit ashtu edhe nga anëtarët e komisioneve zgjedhore me përjashtim të Kryetarit apo anëtarit të ngarkuar nga Kryetari si kordinator me KIZ.
5. Pasi hyn në qendrën e votimit, votuesi **pajiset me dorezat** të cilat vendosen mbi një tavolinë në të djathtë të tij, sapo hyn në Qendrën e Votimit.
6. Më pas ai thotë emrin e tij, programin ku bën pjesë dhe paraqet para komisionit një nga **dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit**, siç janë Karta e Identitetit, Pasaporta apo Karta e Studentit.
7. Kryetari, pasi **verifikon se të dhënat e identitetit të votuesit** përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se votuesi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, (I kërkohet të ulë maskën për identifikim duke respektuar distancimin nga tavolina e Komisionit). Kryetari shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe më pas i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë. □
8. Studenti, që është i pajisur nga një **Vendim i KIZ për të votuar**, pasi hyn në QV e paraqet atë tek kryetari i komisionit në atë Qendër Votimi. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në Fletoren e Protokollit të Ditës së Votimit që më pas futet në Kutinë e Materialeve dhe Dokumentave të Votimit për dorëzim në KIZ.
9. Votuesi **nënshkruan në listën e zgjedhësve** anash emrit të tij.
10. Votuesit student i jepen për të votuar **fletët e votimit**:
 - i. për rektor;
 - ii. për drejtues njësie kryesore;
 - iii. për anëtarë në Senatin Akademik, përfaqësues i studentëve.
11. Votuesit personel akademik, i jepen për të votuar **fletët e votimit**:
 - i. për rektor;
 - ii. për drejtues njësie kryesore;
 - iii. për drejtues njësie bazë në të cilën bëjnë pjesë;
 - iv. për anëtarë të personelit akademik në Senatin Akademik.
12. Çdo fletë e votimit është e vulosur, në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF.
13. Pasi merr fletët e votimit, **studenti hyn i vetëm në dhomën e fshehtë**:

- i. në fletën e votimit për Rektor dhe për Dekan, shënon në krah të emrit të kandidatit shenjën "+"/" x"/" ✓". Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri. Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat zgjedhësi voton duke shënuar shenjat e mësipërme në një nga alternativat e shkruajtura krahas emrit të kandidatit **"Pro" ose "Kundër"**;
 - ii. në fletën e votimit për anëtarë të senatit akademik shënon, në krah të emrave të kandidatëve shenjën "+"/" x"/" ✓". Votuesi duhet të shënojë **jo më shumë se 4 emra**, aq sa është numri i mandateve në Senatin Akademik për përfaqësuesit e tyre, **përndryshe fleta e votimit është e pavlefshme**.
 - iii. pasi bën shënimin e tij në fletën e votimit, ai i palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit sipas modelit në ballinën e kutisë .
14. **Votuesi është i detyruar të hyjë në dhomën e fshehtë për të votuar**, përndryshe nuk lejohet të fusë fletët e votimit në kuti.
 15. Në qendrën e votimit **ndalohe**t kategorisht përdorimi i **aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese**. Votuesi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pangarkuar me çanta, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore.
 16. Me mbarimin e votimit votuesi **heq dorezat plastike dhe i hedh ato në koshin e mbeturinave** në të djathtë të tij.
 17. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit **lejohen** të qëndrojnë vetëm:
 - anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
 - zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
 18. Në qendrën e votimit, gjatë **procesit të numërimit të votave lejohen** të qëndrojnë vetëm:
 - anëtarët dhe sekretari i KZF/KQV-së;
 - kandidatët garues.
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
 19. Kryetari i KZF **në rast të shkeljes së rregullit dhe qetësisë nga pjesëmarrësit e lejuar** në të gjatë numërimit ndërpret procesin e numërimit, bën mbledhjen urgjente të KZF dhe merr Vendimin përkatës për prishësin e standardeve zgjedhore. Për Vendimin komunikon me KIZ dhe ky i fundit me Administratorin e UT për marrjen e masave për sigurinë dhe rendin në institucion.

Komisioni institucional i Zgjedhjeve në Universitetin e Tiranës